



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT
KORÇË
VENDIM**

**Nr P2 Datë 26.11.07
PËR**

**MIRATIM FONDI PËR BLERJEN E DHURATAVE TË FEMIJËVE
TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË ME RASTIN E FESTIMIT TË
FESTAVE TË FUND VITIT**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, i mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Punëve Publike «PËR MIRATIM FONDI PËR BLERJEN E DHURATAVE TË FEMIJËVE TË ADMINISTRATËS SË BASHKISË ME RASTIN E FESTIMIT TË FESTAVE TË FUND VITIT», bazuar në ligjin nr. 8652 dt. 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", neni 32 pika "dh", ligjin nr 8399 dt. 09.09.1998 "Për buxhetin lokal", Ligjin nr 9645 dt. 27.11.2006 "Për buxhetin e shtetit të vitit 2007", Udhëzimin nr 2 dt. 17.01.2007 të M.F. "Për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2007", Udhëzimin nr 353 dt.19.03.2007 të Ministrisë së Brendshme "Për zbatimin e Buxhetit të Qeverisjes Vendore për vitin 2007", si dhe V.K.B. nr. 2 dt. 02.02.2007 "Mbi miratimin e buxhetit të Bashkisë dhe institucioneve të vartësisë për vitin 2007", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimit të anëtarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë fondin prej 80.000 lekë për blerjen e dhuratave për fëmijët e punonjësve të Bashkisë (40 fëmijë x 2000 lekë /person)
2. Ky fond do të përballohet nga fondi rezervë i të ardhurave të Bashkisë, me këtë strukturë buxhetore:

Pakësohet 00 04980 05 Art 6091100 - 80 000 leke

Shtohet 00 01110 05 Art 6020000 + 80 000 leke

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Drejtoria e Personelit, Protokoll-Arkivës dhe Mbështetjes, si dhe Drejtoria Juridike në Bashki.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetare e Këshillit

Raimonda NASE
Raimonda NASE